



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 14/18
Prishtinë, më 15.01.2018, ora 10:30
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajqi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Blerim Kuqi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuarë: Bedri Hamza - Ministër i Financave (tutje Ministri), Shkëlzen Morina - Drejtor në MF, Drini Cano-Ekspert i jashtëm nga MF.

Pjesëmarrës të tjerë: Olf Mathiasson - Projekt Menagjer në Swidish Tax Agency, Shkëlqim Gjema-Zyra Kombëtare e Auditimit, Mirjeta Dervishi - Gazetare Kosova-Post.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozojë që rendi i ditës, të plotësohet me një pikë shtesë: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për standardizim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal. Ne kemi pranuar raportin me amendamente të komisionit funksional, me datë 13.12.2018, për vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit dhe amendamenteve, por për shkak të angazhimeve në shqyrtimin e buxhetit, nuk kemi arritur ta trajtojmë dhe propozojmë që ta shqyrtojmë në mbledhjen e sotme

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës me plotësimin e një pikë të re, e katërta me radhë: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për standardizim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Kryetari – konstatoi se miratohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, dt. 8.12.2017, 15.12.2017, 19.12.2017 dhe 20.12.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

Kryetari – njoftoi se kemi pranuar disa amendamente nga Grupi Parlamentar Lista Serbe dhe deputetja Evgjeni Thaqi-Drangusha, të cilat i kemi të bashkangjitura me material. Për shqyrtimin e këtij projektligji, ne kemi caktuar një grup punues, i cili nuk ka arritur të takohet dhe duke pasur parasysh kërkesën dhe nevojën për procedimin më të shpejtë të këtij projektligji, propozojë që të bëjmë shqyrtimin e tij nën nën dhe të propozojmë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme. Neni 1 dhe 2, nuk ka komente.

Ministri – tek nenin 3, fjalia e parë e paragrafit 1.21, propozojmë të riformulohet si vijon: “Posedim i përbashkët – nënkupton posedimin e pronës së paluajtshme nga dy apo më shumë persona, në pjesë të pacaktuara.

Kryetari – sqaroi se propozimi i ministrisë së financave lidhur me nenin 3, paragrafi 1.21 është i ngjashëm me amendamentin 1 të deputetës Evgjenie dhe do të shkojë si amendament i deputetët me përkrahjen e komisionit.

Kryetari, konstatoi se komisioni unanimitisht, miratoi amendamentin 1 të deputetës Evgjenie Thaqi-Drangusha, me tekstin si në vijim: Neni 3, fjalia e parë e nënparagrafit 1.21, riformulohet si me poshtë: 1.21. Posedim i përbashkët – nënkupton posedimin e pronës së paluajtshme nga dy apo më shumë persona, në pjesë të pacaktuara. (fjalia e dytë e nënparagrafit 1.21. mbetet e pandryshuar).

Kryetari – neni 4 nuk ka koment. Tek neni 5 kemi marrë disa komente nga Drejtoria për Standardizim dhe Përafrim Ligjor e Administratës së Kuvendit, ku thuhet se në nën-paragrafin 5.18 të nenit 21, paragrafin 2, të nenit 22, paragrafin 4 të nenit 23 dhe paragrafin 6 të nenit 33, përmenden disa referenca pas specifikuar se për cilin ligj është fjala, dhe rekomandohet të bëhet specifikimi i ligjit të saktë. Propozojë që të miratojmë këto plotësime.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Në nenin 21, në nënparagrafin 5.18., pas referencës “paragrafin 6 të nenit 35”, shtohet teksti “të këtij ligji”.

Në nenin 22, në paragrafin 2., pas referencës “paragrafin 1 të nenit 16”, shtohet teksti “të këtij ligji”.

Në nenin 23, paragrafin 4., pas referencës “paragrafin 7 të nenit 21”, shtohet teksti “të këtij ligji”.

Në nenin 33, në paragrafin 6, pas referencave “paragrafët 6 deri 12, të nenit 31” dhe referencave “paragrafët 6 deri 9 të nenit 32” shtohet teksti “të këtij ligji”.

Kryetari – neni 6 dhe 7, nuk ka komente. Tek neni 8, pas paragrafit 2, teksti: “v3. Nëse as shfrytëzimi i planifikuar nuk mund”, është përsëritur dy herë në draftligjin në formën fizike dhe propozojë të hiqet.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 8, pas paragrafit 2, hiqet teksti: “v3. Nëse as shfrytëzimi i planifikuar nuk mund”, i cili është përsëritur dy herë në draftligjin në formën fizike.

Kryetari – neni 9 ka të bëjë me normat tatimore dhe për këtë çështje ka pasur diskutime edhe në seancë. Ajo që është me interes të diskutohet është kufizimi i lartësisë së normës deri 1% për njësitë rezidenciale, dhe vlerësojë se një normë e tillë është majftë e lartë.

Ministri - ne e kemi propozuar si opsion prej 0.15% deri në 1% dhe është në harmonizim me standardet për këtë çështje.

Naser Osmani - sa i përket nenit 10, paragrafi 1.6, që flet për lirimin nga tatimi në pronë të paluajtshme të organizatave joqeveritare me status të përfitimit publik, ne kemi problemin me institucionet mikrofinanciare që kanë statusin e OJQ-ve, ndërsa zhvillojnë aktivitete komerciale.

Drini Cano – sqaroi se lidhur me çështjen e lirimeve të institucioneve nga tatimi në pronë të paluajtshme, paragrafi 3 i nenit 10, rregullon që lirimet e përcaktuara për institucionet nga nënparagrafi 1.2-1.7 i këtij neni, nuk zbatohet nëse prona e paluajtshme shfrytëzohet për veprimtari komerciale dhe nëse pronën e paluajtshme në pronësi ose prosedim një organizate joqeveritare me status të përfitimit publik, nuk e shfrytëzon për qëllime të përfitimit publik.

Naser Osmani – në paragrafin 1 të nenit 11, flitet për zbritjen për vendbanimin parësor në shumë monetare prej 15.000 euro. A duhet të jetë në përqindje?

Drini Cano – sqaroi se për vendbanimin kryesore është një ndër masat që përdoren për të mbrojtur shtresat apo personat që nuk kanë shumë të ardhura. Nëse do ta trajtoheshin në 1% atëherë do të përfitonin edhe ata persona që kanë të ardhura të mira, që kanë prona me një vlerë të caktuar dhe prandaj është vendosur shuma fikse.

Kryetari – neni 12 nuk ka komente. Në nenin 14, paragrafi 5, kemi një koment nga Drejtoria për Standardizim, ku rekomandohet që të përcaktohet akti nënligjor përmes se cilit Ministria e financave rregullon çështjen që parashihet me atë nen. Raste të ngjashme thuhet se kemi në paragrafin 6 të nenit 17, paragrafin 13 të nenit 31. Unë propozoj që të bëjmë një amendament dhe në ato nene ku thuhet se ministria apo qeveria rregullon apo përcakton një çështje, të shtohet teksti “me akt nënligjor”

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim:

Në nenin 10, në paragrafin 5, në rreshtin e tretë, pas fjalës “përcaktohen”, shtohet teksti “me akt nënligjor”. Në nenin 12, në paragrafin 3, në rreshtin e katërt, pas fjalës “përcaktohen”, shtohet teksti “me akt nënligjor”. Në nenin 14, në paragrafin 5, në rreshtin e gjashtë, pas fjalës “përcaktohen”, shtohet teksti “me akt nënligjor”. Në nenin 14, në paragrafin 6, në rreshtin e tetë, pas fjalës “përcaktuara”, shtohet teksti “me akt nënligjor.” Në nenin 17, në paragrafin 6, në rreshtin e pestë, pas fjalës “përcaktohen”, shtohet teksti “me akt nënligjor”. Në nenin 24, në paragrafin 5, në rreshtin e parë, pas fjalës “përcakton”, shtohet teksti “me akt nënligjor”.

Kryetari – tek neni 15, paragrafi 1 ku thuhet se Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese“, kemi koment nga Drejtoria për harmonizim, ku sugjeron që të përcaktohet mënyra e angazhimit dhe përzgjedhjes së inspektorëve privat. Tek neni 15 nuk ka propozohen ndryshime. Në nenin 16 nuk ka komente. Tek neni 17, Drejtoria për standardizim, ka komente tek nën-paragrafi 4.4. i cili permend dy (2) anëtarë nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave, që të sqarohet se a propozohen me rotacion apo secili organ perfaqeson me një anëtar.

Ministri – sa i përket nënparagrafit 4.4. propozimi është që të jetë një anëtar nga Banka Qendrore dhe një anëtar nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 17, paragrafi 4, nënparagrafi 4.4., riformulohet me tekstin si vijon: 4.4. një (1) anëtar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe 1 (një) anëtar nga Shoqata e Bankave të Kosovës;

Kryetari - po ashtu në këtë nen kemi amendamentin 2 dhe 3 të propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe. Është propozuar të ndryshohet paragrafi 1. i nenit 17, me tekstin: “Ministria e Financave, me rastin e përcaktimit të zonave të vlerave, si dhe vlerësimit të vlerës së pronës së paluajtshme, kryen konsultime obligueshme me komunat, në të cilat gjenden pronat, e pa pajtueshmërinë e komunave, në të cilat gjendet pronat e paluajtshme, nuk mund të përcaktohen zonat e vlerësimit, niveli si dhe vlerësimi i vlerës së pronës së paluajtshme.” Ndërsa, amendamenti tjetër propozohet që në nenin 17, të shtohet një nënparagraf me tekstin, si vijon: “4.6. Dy përfaqësues të komunitetit serb dhe një përfaqësues i komuniteteve tjera joshumicë.” Unë propozojmë që mos të përkrahim këto amendamente, pasi që nuk kemi të bëjmë me qështje etnike.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nuk përkrahu amendamentet 2 dhe 3 të Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Fikrim Damka – theksoi se në paragrafin 4.5. të nenit 10, po flitet për odat e Kosovës, duhet të sqarohet se si bëhen emërimet të këtij anëtari, kur dihet se kemi disa oda?

Ministri – duhet të jetë Oda Ekonomike e Kosovës, që është e themeluar me ligj, pasi që odat tjera kanë statusin e OJQ-vë.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 17, paragrafi 4, nënparagrafi 4.5, riformulohet me tekstin si vijon: “4.5. një (1) anëtar nga Oda Ekonomike e Kosovës.”

Kryetari – në nenin 18, kemi amendamentet 4, 5 dhe 6 të propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe. Me amendamentin 4, propozohet të bëhen ndryshimi i paragrafit 1 të nenit 18, me tekstin: “Ministria e financave, përmes Departamentit përkatës për tatim në pronë, në pajtueshmëri me komunat në të cilat gjendet prona e paluajtshme, bënë vlerësimin e përgjithshëm njëherë në 3 vite ose 1 herë çdo 5 vite, në bazë të skemës dhe procedurës së përcaktuar me akt nënligjor, i cili është nxjerrë në bazë të paragrafit 1 nenit 17 të këtij ligji.

Drini Cano - përvojat kanë treguar se vlerësimi i pronave nga komunat nuk është bërë si duhet dhe prandaj me këtë projektligj është propozuar centralizimi i funksionit të vlerësimit. Pra, komunat nuk njohuritë e nevojshme, nuk kanë teknologjinë mbështetëse për të bërë vlerësimin e pronave.

Ministri – komunat nuk kanë kapacitetet për të bërë vlerësimin e pronave, nuk kanë vlerësues të certifikuar për të bërë vlerësimin e pronës, siç kërkohet me ligj.

Kryetari – edhe amendamentet 5 dhe 6 të propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, kanë të bëjnë me kërkesën që vlerësimi i pronave të bëhet nga ministria e financave në bashkëpunim me komunat.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nuk përkrahu amendamentet 4, 5 dhe 6 të Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Kryetari – neni 19, 20, 21 dhe 22 nuk ka komente. Neni 23, në paragrafin 1, duhet korigjuar fjala “pagohen”, me fjalën “paguhen”.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 23, në paragrafin 1, fjala “pagohen”, zëvendësohet me fjalën “paguhën”

Kryetari - në paragrafin 9 të nenit 23, lidhur me përgjegjësinë e pagesës së detyrimeve të tatimeve duhet sqaruar dhe specifikuar fjala trashëgimtarët e tij,

Drini Cano – sqaroi se trashëgimtarri i gëzon të gjitha të drejtat e pronës dhe detyrimet që i ka trashëgimlënësi.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 23, në paragrafin 9, në rreshtin e tretë, teksti “trashëgimtarit të tij”, zëvendësohet me tekstin “trashëgimtarit të pronës së tij.”

Kryetari – neni 24 nuk ka komente.

Ministri - në nenin 24, paragrafi 1, ku thuhet “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”, të zëvendësohet me fjalët “Ministria e Financave”. Ky ndryshim duhet të bëhet se BQK nuk parapërcakton norma, por vetëm i publikon të dhënat e tilla.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 25, në paragrafin 1, në rreshtin e katërt, teksti “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”, zëvendësohet me tekstin “Ministria e Financave”

Kryetari – neni 26 nuk ka komente.

Naser Osmani - lidhur me paragrafin 6 të nenit 27, ku parashihet që komuna ne përputhje me legjislacionin ne fuqi të mund të kërkojë nga organet kompetente ndalimin e lëvizjes së debitorit jashtë vendit dhe ndalimin e transfertave monetare të debitorit në bankat jashtë vendit, është një kompetecë që nuk mund ta kenë komunat. Janë institucionet përgjegjëse për këtë çështje.

Drini Cano – sqaroi se është fjala për rastet specifike të tatimpaguesve të mëdhenj debitor që bëjnë evazion të deklarimit të tatimit, dhe në këto raste komuna vetëm mund të marrë iniciativën pranë organeve kompetente, ndërsa janë organet kompetente, si prokuroria, policia, që vendosin për këtë çështje. Kjo ka ardhur edhe si sugjerim nga komunat për shkak të problemeve të natyrës së tillë që janë ballafaquar në të kaluarën.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Në nenin 27, hiqet në tërësi paragrafi 6 dhe nënparagrafët 6.1. dhe 6.2.

Kryetari - neni 28 nuk ka komente. Në nenin 29, paragrafi 3 parashihet që Qeveria përcakton shërbimet komunale që pezullohen, për debitorët që nuk paguajnë tatimin sipas këtij ligji.

Ministri – propozojë që paragrafi 3 i nenit 29, të riformulohet: “Shërbimet komunale që pezullohen për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor që propozohet nga Ministria e Financave dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.”

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Në nenin 29, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si vijon: “3. Shërbimet komunale që pezullohen për zbatimin e këtij neni,

përcaktohen me akt nënligjor që propozohet nga Ministria e Financave dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.“

Ministri – propozojmë që të riformulohet paragrafi 1.1 i nenit 30: “1.1. nga data e përfundimit të periudhës 180 (njëqindetëdhjetë) ditore, në rastet kur detyrimet tatimore të papaguara kanë kaluar shumën e 300 (treqind) eurove përpara mbarimit të afatit 180 (njëqindetëdhjetë) ditor.

Kryetari – lidhur me paragrafin 1.1 të nenit 30, kemi edhe amendamentin 2 të deputetës Evgjëni Thaqi Dragusha, dhe do të shkojë si amendament i deputetët me përkrahjen e komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht përkrahu amendamentin 2 të deputetës Evgjëni Thaqi – Dragusha, si vijon: Neni 30, nënparagrafit 1.1, riformulohet me tekstin si vijon: “1.1. nga data e përfundimit të periudhës 180 (njëqindetëdhjetë) ditore, në rastet kur detyrimet tatimore të papaguara kanë kaluar shumën e 300 (treqind) eurove përpara mbarimit të afatit 180 (njëqindetëdhjetë) ditor;”

Kryetari – neni 31 nuk ka komente. Neni 32, kemi një koment të Drejtorisë për standardizim, ku thuhet se në paragrafin 6, përmendet një afat prej gjashtëdhjetë (60) dhe tridhjetë (30) ditësh për marrjen e vendimit në lidhje me ankesën, mirëpo, nuk është specifikuar se a është fjala për ditë pune apo kalendarike.

Drini Cano - sqaroi se në të gjitha dispozitat e projektligjit ku është dashur të konkretizohet dite pune, është shkruar “dite pune”. Ndërsa në ato raste që nuk thuhet pune, po thjesht ditë është nënkuptuar si ditë kalendarike dhe ka një udhëzim që ka nxjerr Qeveria për të sqaruar këtë.

Kryetari - unë mendojë që duhet specifikuar rastet e ditëve të punës dhe ditëve kalendarike dhe propozojë kjo të rregullohet me një amendament në të gjithë dispozitat e projektligjit.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 14, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, Neni 18, paragrafi 8, Neni 20, paragrafi 5 dhe paragrafi 6, Neni 21, paragrafi 3, Neni 22, paragrafi 3, Neni 24, paragrafi 4, Neni 27, paragrafi 1, Neni 30, paragrafi 1, Neni 31, paragrafi 6, paragrafi 9, paragrafi 10, paragrafi 11 dhe paragrafi 12, Neni 32, paragrafi 6 dhe paragrafi 9, Neni 33, paragrafi 2, Neni 34, paragrafi 1, Neni 35, paragrafi 2 dhe paragrafi 3 - Në të gjitha këto dispozitat e lartpërmendura, pas fjalës “ditë/ditëve”, shtohet fjala “kalendarike” (Ky ndryshim nuk është i vlefshëm në ato raste ku përmendet ditë/ditëve pune).

Kryetari - neni 33 nuk ka komente.

Ministri – tek neni 34, paragrafi 2 ku thuhet “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”, propozojmë të zëvendësohet me “Ministria e Financave”.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 34, në paragrafin 2, teksti “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”, zëvendësohet me tekstin “Ministria e Financave”

Ministri – neni 35, tek paragrafi 7, propozojë që aty ku përmendet “sanksionet kundërvajtëse” sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtje”, të hiqet fjala “për kundërvajtje”, sepse ka mbetur gabimisht.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 35, në paragrafin 7, në reshtin e katërt, pestë dhe të tetë, hiqet teksti “për kundërvajtje”.

Kryetari - tek Kapitulli X, kemi një koment nga Drejtoria për standardizim, ku propozon që në titull të hiqet fjala “të ndryshme”, pasi që një praktikë e tillë nuk është aplikuar gjerë me tani, sikurse nuk e mbështet as udhëzimi administrativ 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Kapitulli X, në titullin e këtij kapitulli, hiqen fjalët “TË NDRYSHME”

Kryetari - në nenin 36, paragrafi 1, kemi amendament të propozuar nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, si vijon: Në qoftë se me dispozitë të këtij ligji është përcaktuar që tatimpaguesit t’i dërgohet lajmërim me shkrim dhe/ose ndonjë akt tjetër zyrtar, konsiderohet se ky obligim është përmbushur në qoftë se ekziston dëshmia për pranimin e aktit, përkatësisht dëshmia se personi ka refuzuar për ta pranuar aktin.

Drini Cano - problemi me adresat është një problem i madh në Kosovë, prandaj është parashikuar mënyra e një procedurë për njoftimin e tatimpaguesve që me marr në mënyrë reale faturën dhe janë përcaktuar disa mënyra të njoftimit dhe dorëzimit të faturës. Në projektligj është përcaktuar që Ministria e Financave të krijojë një link të veçantë për publikimin e faturave. Nga ana tjetër komuna nga ana ligjore obligohet që njoftimin ta bëjë personalisht përmes njoftimit zyrtar. Neni 37 ka përcaktuar që zyrtari i komunës, personalisht ti dorëzojë këto akte dhe janë përcaktuar mënyrat dhe afatet e ndryshme për njoftimin, respektivisht dorëzimin e faturës tek tatimpaguesi.

Ministri – me qëllim të lidhshmërisë të dispozitave, propozojë që në paragrafin 6 të nenit 36, në fund të shtohet teksti “në pajtim me neni 16 të këtij ligj”.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 36, paragrafi 6, në rreshtin e tretë, pas fjalës “ditë”, shtohet fjala “kalendarike”. Po ashtu në paragrafin 6 të këtij neni, në fund të fjalisë, shtohet teksti “siç parashihet me këtë ligj”. Ndërkaq, Komisioni nuk përkrahu amendamentin 7 të Grupit Parlamentar Lista Serbe, për ndryshimin e paragrafit 1 të nenit 36.

Kryetari – në nenit 36, kemi edhe një propozim nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, për fshirjen e paragrafit 6, që ndërlidhet me amendamentin paraparak të propozuar nga ky grup.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nuk përkrahu amendamentin 8 të Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Ministri – propozojë që në paragrafin 3 të nenit 37, teksti “Zyrës Komunale në Tatimin në Pronë”, të zëvendësohet me fjalën “Komunës”

Kryetari - lidhur me paragrafin 3 të nenit 37, kemi edhe amendamentin 3 të deputetës Evgjeni Thaqi – Dragusha, dhe do të shkojë si amendament i deputetët me përkrahjen e komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht amendamentin 3 të deputetës Evgjeni Thaqi – Dragusha, si në vijim: Neni 37, në paragrafin 3, togfjalëshi “Zyrës Komunale të Tatimit në Pronë”, zëvendësohet me fjalën “Komunës”

Kryetari – Grupi Parlamentar Lista Serbe, me amendamentin 9, ka propozuar që paragrafi 4 i nenit 37 të ndryshohet si në vijim: Lajmërimi dhe/ose ndonjë akt tjetër do të konsiderohet i vlefshëm në rastet kur personi apo ndonjë i afërm i tij refuzon për ta pranuar lajmërimin dhe/ose një akt zyrtar. Ky amendamenti ndërlidhet me dy amendamentet tjera të propozuar nga ky grup parlamentar në nenin 36.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nuk përkrahu amendamentin 9 të Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Kryetari – Grupi Parlamentar Lista Serbe, në amendamentin 1, ka propozuar të ndryshohet neni 39. Për sa e kam kuptuar unë ndryshimi është se me këtë amendament është hequr mundësia që Komunat të bashkëpunojnë me Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me qëllim të identifikimit të personave prona e të cilëve është e uzurpuar. Unë mendojë duhet të mbetet siç është neni në projektligj, pasi që Agjencioni funksion edhe për këtë qëllim.

Drini Cano – theksoi se është një përsëritje e dispozitave të formuluar në një mënyrë tjetër dhe ekziston në nenin 6.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nuk përkrahu amendamentin 1 të Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Kryetari – kemi edhe dy rekomandime nga stafi mbështetës për riformulimin e nenit 40 dhe 42, si vijon: Neni 40, të riformulohet, me tekstin si në vijim: “Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxjerrjen brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe fillojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.” Ndërsa neni 42, të riformulohet, me tekstin si në vijim: “Ky ligj publikohet në Gazetën Zyrtare dhe hyn në fuqi me 1 tetor 2018. Ndryshimi i parë ka të bëjë që aktet nënligjore parashihen të nxjerren brenda gjashtë muajsh nga dita e publikimit të Ligjit në Gazetën Zyrtare, dhe ato nuk mund të hynë në fuqi pa hyrë vetë ligji, që është propozuar të jetë me 1 tetor 2018. Ndërsa, ndryshimi i dytë, është bërë për shkak të gjuhës juridike, ku fillimisht duhet publikohet ligji në Gazetën Zyrtare, pastaj të hyjë në fuqi.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht propozoi amendamentin si në vijim: Neni 40, të riformulohet, me tekstin si në vijim: Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxjerrjen brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe fillojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Neni 42, të riformulohet, me tekstin si në vijim: “Ky ligj publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi me 1 tetor 2018.”

Pas përfundimit të diskutimeve, dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht, vendosi që Raportin me amendamentet e propozuara për Projektligjin nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, të procedohen për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme dhe në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për standardizim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal

Kryetari – theksoi se në bazë të Deklaratës së Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, e vitit 2017 dhe vlerësimet janë bërë për vitet 2017-2019, thuhet se projektligji ka kosto shtesë buxhetore prej 90,508 euro. Në buxhetin e vitit 2018-2020, kemi një rritje të buxhetit të Agjencisë për standardizim prej 42,639 euro. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë

Ministri – kostoja shtesë buxhetore do të jetë e përballeshme për Buxhetin e Kosovës.

Pas diskutimeve dhe në bazë në propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-019 për Standardizim, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

**Kryetari komisionit,
Lumir Abdixhiku**
